

Data 04.12.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

‘Blerje kite dhe reagentë për Nevojat e NJVKSH Tiranë për 12 muaj,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kite dhe reagent 33696300-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **7 992 867** (shtate milion e nentëqind e nentëdhjetë e dy mijë e teteqind gjashtëdhjetë e shtatë) **Lekë pa TVSH**

Shumatorja e çmimeve për njësi është: 284,870 (dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) **lekë pa tvsh**

Sqarim: Në mbështetje të VKM-së Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 62 pika 5 ofertimi i operatorëve ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi dhe për efekt krahasimi edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përlllogaritur për cdo artikull/zë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor ” Tirane**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, me objekt aktiviteti te certifikates në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- b) Operatori ekonomik ofertues ne rastet **kur nuk eshte prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet te paraqese autodeklarate** qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi **eshte i certifikuar konform standarteve te cilesise ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, **të vlefshme**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

AK rezervon te drejten per verifikimin e vetedeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit dhe ne rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet te paraqese certifikaten ne fjale.

- c) Kerkohet **Autodeklarate** për materialet mjekësore **kite, reagente, konsumablet** nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformitetin me normat **98/79/EC** ose (EU) **IVDR**

2017/746 ose EU 2016/425 ,ose MDD 93/42/EEC (sipas aplikimit të vlefshmërisë) ose (EU) 2017/745 - MDR, (kur është e aplikueshme), bashkelidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, ose certifikim FDA. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.

Argumentimi: Këto kritere të percaktuar në piken a) b) dhe c) janë vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.* Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.* Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera mesatare e tyre të jete **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit* për të cilat konkurron operatori.**

Shënim: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: **2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.**

Shënim: Nëse operatorët ekonomikë, që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur. AK është e vetmja qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;*si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.3 Kapaciteti teknik:

- a. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.
 - Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohenvlera, afati i përfundimit të kontratën ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atëpublik.

- b. **Për artikullin e kërkuar** sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike), **te paraqitet Katalogje, ku te përfshihen specifikimet teknike te hollësishme për artikullin e kërkuar**(pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur nga anetari i NJP që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 4 pikë 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së kитеve, reagenteve, e materialeve mjekësore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5. Objekti i

prokurimit është specifik, dhe impakti që ka finalizimi me sukses i kësaj kontrate sjell përfitimi në fushën e diagnostikimit të disa lloje sëmundjes nga Laboratori i Anatomi Patologjisë dhe përcaktimin e trajtimit përkatës, pra zgjedhjen e terapisë së duhur.

- c. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese **Autorizim të leshuar nga Prodhuesi / MAH / Distributori Zyrtar i Autorizuar** (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje mallrat (materialet mjekësore) objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

***Shënim:** Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Argumentimi: Ky kriter vendos në mbështetje të praktikës së suksesshme të ndjekur në vite nga AK,. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor., si dhe pikën 8 të nenit 40 ‘Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave’ ku parashikohet se: 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatorin ekonomik ofertues (ref. **Vendimit të KPP nr. 353/2014**). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të **Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “**Rekomandim mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik**”. AK ka parashikuar formën deklarative të autorizimit në këtë procedurë prokurimi në momentin e ofertimit në mënyrë që të respektojë parimet e legjislacionit të prokurimit publik. Përpara lidhjes së kontratës OE i renditur i pari ka detyrimin të provojë këtë deklaram, duke paraqitur autorizimin e firmës

prodhuese/MAH/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi, duke garantuar në këtë mënyrë, aftësinë për të zbatuar kontratën në kohë dhe me cilësi.

- d. Operatori ekonomik duhet të paraqese **oferten teknike**, për artikujt e kërkuar në formë tabele, ku të plotësohet: **Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit**, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatëse për produktet.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga anetari i Njesisë së Prokurimit që ka specialitet perkatëse në lidhje me kriteret teknike, me qëllim që të identifikohet përmbushja e specifikimeve teknike për artikujt e kërkuar si dhe është në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”**, në të cilën është e percaktuar se: *1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.* Gjithashtu ky kriter është në përputhje me piken 2 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *2. Për mallrat që do të prokurorohen, autoritetet/entitet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurorohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

KITE DHE REAGENTË

Nr.	Artikulli	Specifikime	Njesia
1	Acid sulfurik	H2SO4 me pasterti ≥ 95-98%,shisheqelqi ne paketim 1 Lit	Lit
2	Acetat Amoni	NH4CH3CO2	gram
3	Amphotericine B	Disqe te ngopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon
4	Anti Coli	Tipi 1	Flakon
5	Anti Coli	Tipi 2	Flakon
6	Anti HCV	Kasete , Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin cilesor te antitropave te Hep C ne serum plazemosegjak.	Teste (Cope)
7	Anti Salmonela	Polivalente	Flakon
8	Anti Salmonela	O9	Flakon
9	Antigen Brucella melitensis	PlusKontrollpozitiv	Kuti
10	Antigen Brucella abortus	PlusKontrollpozitiv	Kuti
11	Antigen Paratyphi A	Somatic AO	Flakon
12	Antigen Paratyphi A	Flagjelar AH	Flakon
13	Antigen Paratyphi B	Somatic BO	Flakon
14	Antigen Paratyphi B	Flagjelar BH	Flakon
15	Antigen Salmonela	Typhi O	Flakon
16	Antigen Salmonela	Typhi H	Flakon
17	ASLO kit	Bufer + kontrolle	Kuti
18	Bactrine	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
19	Blood agar	Terrenbaze per pergatitjen e pjatave agar-gjak	Kg
20	Ceclor	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
21	Cefepime	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
22	Ceftazidim	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon

23	Ceftraxion	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
24	Cefuroxim	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
25	Ciprofloxacine	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
26	Clarithromycin	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
27	Clotrimazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon
28	Cryptosporidium Giardia combi	test rapid	Teste
29	DC	Dezoksikolat citrate agar.Iperdorur ne pergatitjen e terreneve selektive per izolimin e bakteve enterike	Kg
30	Doxacycline	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
31	DPD1	Nr.1 tableta per matjen e kloritte lire me limit dedektimi 0.01-6 mg/l, C ₆ H ₁₂ N ₂ , N,N-diethyl-p-phenylenediamine	Tableta
32	Econazoli	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon
33	Ekstraktmishi	Pluhur, ingredient per terrenet e ujit	Gram
34	Endo agar	Terren per testet finale dhe konfirmueset e coliforms ne uje	Kg
35	Erythromicin	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
36	Ekstraktmajaje	Pluhur I perdorur ne pergatitjen e terreneve mikrobiologjike	Gram
37	Fluconazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon
38	Gentamicin	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
39	Gonorreja	Rapid test, 1 kuti me 25 cope	Kuti
40	HbsAg	Kasete ,Rapid test/Test I shpejteimunokromatografik per percaktimin e antigenit siperfaqesortehapatitit B ne serum ose plazma. .	Teste (Cope)
41	Hidroksid amoni	NH ₄ OH, Pure	Lit
42	HIV1&HIV2	Kasete ,Rapid test/Test I shpejteimunokromatografik per zbulimin e antitrupeve HIV1&HIV2 ne gjak dhe ne serum. ..	Teste (Cope)
43	Imipenem	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
44	Itraconazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon
45	Ketokonazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon
46	KIA	Pluhur per percaktimin e bakteve enterite	Gram
47	Kite fece gjak okult	test rapid	Teste
48	Kite fece Helicobakter Pylori	test rapid	Teste
49	Klamidia	Rapid test, 1 kuti me 30 cope	Kuti
50	Kontroll polivalent pozitive	Per antigenet febrile te salmones	Flakon
51	Meropenem	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
52	Miconazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon

53	Myllerhinton	Pluhur, ngjyre bezhe i perdorur ne pergatitjen e terreneve mikrobiologjike,tretet mire ne uje	Kg
54	Nessler	Paketim 1 lit, Pure	Lit
55	Nitrofurantoin	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
56	N-naftiletilendiamin	C12H14N2, Pure	Gram
57	Nystatin	Disqe te ngopura per mycograme,1 Flakon me 50 disqe	Flakon
58	Ox19	Antigen Ox19 per Rikecia	Flakon
59	Penicilline	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
60	Rose Bengal test	Plus kontroll	Kuti
61	Saburo agar	Pluhur per percaktimin e mykut	Kg
62	Shigele Flexner	serum	Flakon
63	Shigele Boydi	serum	Flakon
64	Shigele Polivalente	Serum antigenic i cili vërteton shigelen (e ndan nga te tjerat)	Flakon
65	Shigele Sonei	serum	Flakon
66	Staphylococcus test	Rapid test per specifikimin e Staphylococcus, paketimi 1 kuti/2 flakon	Kuti
67	Stereptococcus test	Rapid test per specifikimin e Stereptococcus, strep groupong rapid latex test kit	Kuti
68	Sulfanil amid	C6H8N2O2S, Pure	Gram
69	SulfatZinku	ZnSO4, paketimi 1 kuti/ 1 kg	kuti
70	Syphilis	Kasete , Test I shpejteimunokromatografik per percaktimin e syphilis .	Teste (Cope)
71	Tobramicine	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
72	Tuba me xhel	Tuba me xhel per marrjen e gjakut, tuba 5 ml pa llogaritur xhelin ose 7 ml duke llogaritur xhelin	cope
73	MacConkey	Terren I lengshem per identifikimin e enterokoqeve ne uje dhe ushqim	kg
74	XLD agar	Terren per izolimin dhe diferencimin e bacileve gram negativ	gram
75	Klimer agar	Terren diferencues per identifikimin e koliformeve ne ujin e pijshem	kg

76	EC Medium me MUG(4-methylumbelliferyl-β-D-glucuronide)	Terren per dedektimin e E-Coli ne uje dhe ushqime	kg
77	Jodur kaliumi	Potassium Iodide, rapid test per percaktimin e jodurit te kaliumit ne kripe	Flakon
78	Jodat kaliumi	Potassium Iodate, rapid test per percaktimin e jodatit te kaliumit ne kripe	Flakon

- **Afati i skadencës:** Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

KITE DHE REAGENTË

Nr.	Artikulli	Specifikime	Njesia	Sasia
1	Acid sulfurik	H2SO4 me pasterti ≥ 95-98%,shisheqelqi ne paketim 1 Lit	Lit	4
2	Acetat Amoni	NH4CH3CO2	gram	500
3	Amphotericine B	Disqe te ngopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
4	Anti Coli	Tipi 1	Flakon	1
5	Anti Coli	Tipi 2	Flakon	1
6	Anti HCV	Kasete , Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin cilesor te antitropave te Hep C ne serum plazemosegjak.	Teste (Cope)	5,000
7	Anti Salmonela	Polivalente	Flakon	3
8	Anti Salmonela	O9	Flakon	3
9	Antigen Brucella melitensis	PlusKontrollpozitiv	Kuti	2
10	Antigen Brucella abortus	PlusKontrollpozitiv	Kuti	2
11	Antigen Paratyphi A	Somatic AO	Flakon	3
12	Antigen Paratyphi A	Flagjelar AH	Flakon	3

13	Antigen Paratyphi B	Somatic BO	Flakon	3
14	Antigen Paratyphi B	Flagjelar BH	Flakon	3
15	Antigen Salmonela	Typhi O	Flakon	3
16	Antigen Salmonela	Typhi H	Flakon	3
17	ASLO kit	Bufer + kontrolle	Kuti	3
18	Bactrine	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	50
19	Blood agar	Terrenbaze per pergatitjen e pjatave agar-gjak	Kg	1
20	Ceclor	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	50
21	Cefepime	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	50
22	Ceftazidim	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	50
23	Ceftraxion	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	50
24	Cefuroxim	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	50
25	Ciprofloxacine	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	40
26	Clarithromycin	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	40
27	Clotrimazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
28	Cryptosporidium Giardia combi	test rapid	Teste	50
29	DC	Dezoksikolat citrate agar. Iperdorur ne pergatitjen e terrenevelektive per izolimin e baktereveenterike	Kg	10
30	Doxacycline	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	40
31	DPD1	Nr.1 tableta per matjen e kloritte lire me limit dedektimi 0.01-6 mg/l, C ₆ H ₁₂ N ₂ , N,N-diethyl-p-phenylenediamine	Tableta	10,000
32	Econazoli	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
33	Ekstraktmishi	Pluhur, ingredient per terrenet e ujit	Gram	500

34	Endo agar	Terren per testet finale dhekonfirmuesete coliforms ne uje	Kg	10
35	Erythromicin	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	40
36	Extraktmajaje	Pluhur I perdorur ne pergatitjen e terrenevemikrobiologjike	Gram	200
37	Fluconazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
38	Gentamicin	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	50
39	Gonorreja	Rapid test, 1 kuti me 25 cope	Kuti	5
40	HbsAg	Kasete ,Rapid test/Test I shpejteimunokromatografik per percaktimin e antigenitsiperfaqesortehepatitit B ne serum oseplazma. .	Teste (Cope)	7,000
41	Hidroksid amoni	NH4OH, Pure	Lit	1
42	HIV1&HIV2	Kasete ,Rapid test/Test I shpejteimunokromatografik per zbulimin e antitrupavete HIV1&HIV2 ne gjakdhe ne serum. ..	Teste (Cope)	6,000
43	Imipenem	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	40
44	Itraconazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
45	Ketokonazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
46	KIA	Pluhur per percaktimin e bakteveenterite	Gram	500
47	Kite fece gjak okult	test rapid	Teste	2,200
48	Kite fece Helicobakter Pylori	test rapid	Teste	2,000
49	Klamidia	Rapid test, 1 kuti me 30 cope	Kuti	4
50	Kontroll polivalent pozitive	Per antigenet febrile te salmoneles	Flakon	2
51	Meropenem	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon	40
52	Miconazole	Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
53	Myllerhinton	Pluhur, ngjyre bezhe i perdorur ne pergatitjen e terreneve mikrobiologjike,tretet mire ne uje	Kg	3.5
54	Nessler	Paketim 1 lit, Pure	Lit	7
55	Nitrofurantoin	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon	50

56	N-naftiletlendiamin	C12H14N2, Pure	Gram	80
57	Nystatin	Disqe te ngopura per mycograme,1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
58	Ox19	Antigen Ox19 per Rikecia	Flakon	1
59	Penicilline	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	40
60	Rose Bengal test	Plus kontroll	Kuti	1
61	Saburo agar	Pluhur per percaktimin e mykut	Kg	4
62	Shigele Flexner	serum	Flakon	2
63	Shigele Boydi	serum	Flakon	2
64	Shigele Polivalente	Serum antigenic i cili vërteton shigelen (e ndan nga te tjerat)	Flakon	2
65	Shigele Sonei	serum	Flakon	2
66	Staphylococcus test	Rapid test per specifikimin e Staphylococcus, paketimi 1 kuti/2 flakon	Kuti	3
67	Stereptococcus test	Rapid test per specifikimin e Stereptococcus, strep groupong rapid latex test kit	Kuti	2
68	Sulfanil amid	C6H8N2O2S, Pure	Gram	100
69	SulfatZinku	ZnSO4, paketimi 1 kuti/ 1 kg	kuti	20
70	Syphilis	Kasete , Test I shpejteimunokromatografik per percaktimin e syphilis .	Teste (Cope)	6,200
71	Tobramicine	1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon	40
72	Tuba me xhel	Tuba me xhel per marrjen e gjakut, tuba 5 ml pa llogaritur xhelin ose 7 ml duke llogaritur xhelin	cope	9,000
73	MacConkey	Terren I lengshem per identifikimin e enterokeveve ne uje dhe ushqim	kg	20
74	XLD agar	Terren per izolimin dhe diferencimin e bacileve gram negativ	gram	500
75	Klimer agar	Terren diferencues per identifikimin e koliformeve ne ujin e pijshem	kg	0.5

76	EC Medium me MUG(4-methylumbelliferyl-β-D-glucuronide)	Terren per dedektimin e E-Coli ne uje dhe ushqime	kg	0.5
77	Jodur kaliumi	Potassium Iodide, rapid test per percaktimin e jodurit te kaliumit ne kripe	Flakon	25
78	Jodat kaliumi	Potassium Iodate, rapid test per percaktimin e jodatit te kaliumit ne kripe	Flakon	25

- **Kontratat do te jepen brenda periudhës:** nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuadër me Operatorin ekonomik të shpallur fitues, me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimet:

Për cdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrimet do të jenë si më poshtë:

-40% e mallit për materialet kite, reagentë, konsumabël etj., duhet të lëvrohet maksimumi brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës

-pjesa tjetër sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Specifikimet teknike jane vendosur ne baze te relacionit për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike me nr. 3054/5 prot.,date 21/11/2023, si dhe ne perputhje me nenin 4,pika 38/b, nenin 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne baze te relacionit për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike me nr. 3054/5 prot.,date 21/11/2023, si dhene perputhje me piken 3, germa b te nenit 15 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT